




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Raporti Narrativ për vitin janar –dhjetor 2024

Spektori i të dretjave te njeriut ,Zyra për Barazi Gjimore

Aktivitetet e realizuara për vitin 2024 janë:

- 1.Ne bashkëpunim me organizaten RRRGR me daten 06.02.2024 eshte mbajtur trajnim per dhunen seksuale per antaret e mekanizmit Komunal kundër dhunës ne familje.
Ne këtë trajnim kanë marr pjesë 13 gra dhe 3 burra.
- 2.Tryezë me gratë e fashatit Runik me daten 09.02.2024 ,numri i grave pjesëmarrëse ka qenë 11,tema e diskutimit sesion informues rreth granteve dhe subvencioneve ne hapjen e start Ap Bizneseve .Informimin e beri drejtoresha e Zhvillimit ekonomik zj.Besarta Meha Ademi ,prezente ne kete takim ishte dhe zyrtarja kunder diskriminimit zj.Redona Shala.Kosto e ketij aktiviteti ka qenë 50 €.
- 3.Per festen e dites nderkombetare te gruas 8 Marsit eshte mbajtur aktivitet me temen fuqizimi i gruas ne vendimarrje dhe ne shoqeri, ku pjesmarres kanë qenë 158 gra, të të gjitha dikastereve si:gra te sherbimit civil,perfaqsuere te policisë se Kosoves,perfaqsuere te shkollave ,perfaqsuere te shoqerisë civile ,perfaqsuere te shendetësisë .Kosto e ketijë aktiviteti ka qenë 2.844.00 €.
Ne këtë takim mbajti fjalim kryetari Komunës se Skenderajt z.Fadil Nura , ju ofrua perkrahje institucionale ne fuqizimin e gruas ne shoqeri.
Zyrtarja per barazi gjimore mbajti sesion informues rreth ligjit per barazi gjimore dhe ligjit te zgjedhjeve.
Drejtoresha e Zhvillimit ekonomik zj.Besarta Meha Ademi ju dha informacione rreth granteve dhe subvencioneve me te cilat i mbeshket gratë dhe vajzat ne fuqizimin ekonomik te tyre.
- 4.Ne maj te vitit 2024 zyrtarja per barazi gjimore se bashku me zyrtaren kunder diskriminimit kane mbajtur nje tryezë diskutimi per degjimet buxhetore dhe rendesine e pjesëmarrjes ne keto degjime . Ne kete tryezë ishin te pranishme 17 gra dhe vajza te fshatit syrganë Komuna e Skenderajt. Per kete takim nuk eshte shpenzuar buxhet.
- 5.Ne maj te vitit 2024 është mbajtur sesion informues kundër dhunës ne familje dhunës ne baza gjimore dhe trafikimit me qenje njerëzore ,gjithashtu shperndarë dhe broshura me informata per mekanizmat mbrojtës kundër dhunës dhe kundër trafikimit me qenje njerëzore.Buxheti për broshurat ka qenë 200€.
Në këtë takim moren pjese 15 gra dhe vajza.
- 6.Zyrtarja për Barazi Gjimore së bashku me zyrtaren kundër dikskriminimit kanë mbajtur takim me kryesin e shoqatës se pensionisteve te Komunës se Skenderajt ,ku janë diskutuar shumë qershtje për të drejtat e tyre dhe mundesitë te cilat mund ti ofrojë Komuna per realizimin e kerkesave te tyre.Të pranishem ishin 6 gra dhe 5 burra.Nuk është shpenzuar buxhet për këtë aktivitet.
- 7.Ne korrik te vitit 2024 ne bashkëpunim me OJQ ,” Qendra për Promovimin e te Drejtave te Grave”zj.Kadire Tahiraj eshte mbajtur tryezë me të mbijetuarat e luftës se fundit ne Kosovë te cilat I kemi informuar rreth projektit te Organizates FAO e cila do ti perkrah ne fushen e bujqesisë per fuqizimin etyre ekonomik.
Ne këtë takim kanë marrë pjesë 15 gra.Buxhetin për këtë aktivitet e ka mbuluar organizata.
- 8.Në korrik të vitit 2024 është mbajtur ligjeratë kundër dhunës në baza gjimore ne fashtin Kryshec komuna Skenderaj .
Ligjeratën e kanë mbajtur Edona Gashi dhe Erza Musliu project i fituar nga W4W.

Numri i grave dhe vajzave pjesëmarrëse ishte 15. Nuk ka pasur shpenzime për këtë aktivitet.

9. Në korrik të vitit 2024 në bashkëpunim me OJQ "Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave" u mbajt tryezë diskutimi me përfaqësues të institucioneve komunale për adresimin e efekteve afatgjate të dhunës seksuale dhe përfundimi i stigmatizimit të të mbijetuarve të dhunës seksuale dhe antareve të familjeve të tyre gjatë luftës në Kosovë.

Në këtë takim morën pjesë 7 burra dhe 16 gra. Shpenzimet e takimit i ka mbuluar organizata.

10. Në korrik të vitit 2024 në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe NDI u realizua debate me temën Fuqizimi ekonomik i grave dhe të rinjeve, ku panelist ishin zyrtari i lartë financiar në Komunën e Skenderajt .z.Besart Geci ,drejtoresha e zhvillimit ekonomik znj.Besarta Meha Ademi ,zyrtarja për rini sport dhe kulturë znj.Albulena Hoxha si dhe përfaqësuesja e shoqërisë civile znj.Gentiana Zeqiri.Shpenzimet e mbuluara nga NDI.Në këtë takim morën pjesë 17 gra dhe 2 burra.

11. Në shtator të vitit 2024 në bashkëpunim me OJQ "Humans Vita" është realizuar një puntori për hartimin e strategjisë së punës me përfaqësues të bizneseve ku morën pjesë 13 përfaqësues të bizneseve .Në këtë takim të pranishëm ishin zëvendës ministri i Zhvillimit rajonal si dhe drejtoresha e zhvillimit ekonomik e Komunës së Skenderajt.OJQ Humans Vita ka kryer shpenzimet e aktivitetit duke i paisur pjesëmarrësit me certifikata.

12. Në Maj të vitit 2024 është mbajtur takim me përfaqësues të QPS.përfaqësues të strehimores,përfaqësues të ndihmes juridike falas,përfaqësues të shoqërisë civile ,ku është diskutur për planin e veprimit të mekanizmit kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.Numri i pjesëmarrësve ishte 9 veta ,6 gra dhe 3 burra.Për këtë takim nuk u shpenzua buxhet.

13. Në maj të vitit 2024 në bashkëpunim me W4W është mbajtur trajnim 3 ditor me antaret e mekanizmit komunal kundër dhunës ,në të cilin trajnim kanë qenë prezente 5 gra dhe 1 burr,gjithashtu është hartuar plani i veprimit për mekanizmin kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

14. Në maj të vitit 2024 Zyra për Barazi Gjinore ka përkrah OJQ për aktivitetet për të drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore me 10.000 €.

15. Në Prill të vitit 2024 janë shpërndarë posterë informues mbi diskriminimin dhe antigjyptizmin.

16. Mekanizmi Komunal Kundër dhunës në familje ka mbajtur 4 takime në vit.

17. Eshatë përkrahur strehimorja me 2.500 €

18. Tetori hapja e fushatës së ndergjegjësimit kundër kancerit të gjirit ,përmes webfaqes së komunës, rrjeteve sociale si dhe ndriqimi me ngjyrën Rozë të objektit të komunës në solidarizim të rasteve të prekura me kancer të gjirit.Shuma për këtë aktivitet 1000€.

19. Me 16 tetor është mbajtur marshi për ndergjegjësimin e kancerit të gjirit dhe në bashkëpunim me shkollat janë shitur ushqime tradicionale nga nxënësit të cilat mjetet janë dedikuar grave të prekura me kancer të gjirit.Numri i pjesëmarrësve në marsh ka qenë mbi 200 veta.shpenzimet për shallat,posterat ,fjongot,kapelet ka qenë 500€.

20. Në bashkëpunim me OJQ,Hasan Tahsin është mbajtur ligjeratë për kancerin e gjirit .Ligjeratën e ka mbajtur onkologja Vildana Goga Çmega dhe psikologja Sadete Çitaku.pjesëmarrës në këtë ligjeratë kanë qenë 100 gra .Shpenzimet për këtë aktivitet kanë qenë të përbashkëta komuna ka shpenzuar 98 €.

21. Në kuadër të "16 ditëve të Aktivizmit kundër trafikimit me qenje njerëzore " me 5 Tetor në bashkëpunim me policinë e Kosovës, janë mbajtur ligjerata kundër trafikimit me nxënës në shkollën fillore " Drenica " në Polac.Në këtë aktivitet janë shpërndarë broshura vetdijësuese.Numri i nxënësve ka qenë 52 vajza dhe 46 djem.

22. Në kuadër të "16 ditëve të Aktivizmit kundër trafikimit me qenje njerëzore" me 6 Tetor në bashkëpunim me policinë e Kosovës, janë mbajtur ligjerata kundër trafikimit me nxënës në shkollën fillore "Azem Bajraktari " në fshatin Prekaz i Epërm.Numri i nxënësve në këtë ligjeratë ka qenë 43 vajza dhe 36 djem. Janë shpërndarë broshura me informacione për mekanizmat mbrojtës .

23. Në kuadër të "16 ditëve të Aktivizmit kundër trafikimit me qenje njerëzore" me 6 Tetor në bashkëpunim me policinë e Kosovës, janë mbajtur ligjerata kundër trafikimit me nxënës në shkollën fillore "Shote Galica" në Runik.Numri i pjesëmarrësve në ligjeratë 37 vajza dhe 32 djem. Janë shpërndarë broshura me informacione për mekanizmat mbrojtës .

24. Në kuadër të "16 ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në familje " me 26 Nëntor janë mbajtur ligjerata në bashkëpunim me policinë e Kosovës në shkollën fillore " Ismet Uka " në fshatin Ticë.numri i pjesëmarrësve ka qenë 29 djem dhe 38 vajza,gjithashtu janë shpërndarë broshura me informata për mekanizmat mbrojtës kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

25. Në kuadër të "16 ditëve të Aktivizmit kundër dhunës në familje " me 27 Nëntor janë mbajtur ligjerata në bashkëpunim me policinë e Kosovës në shkollën fillore "Vëllezërit Frashërit Çubrel".Numri i pjesëmarrësve ka qenë 42 vajza dhe 32 djem, gjithashtu janë shpërndarë broshura vetdijësues.

26.Me 29 Nentor është mbajtur trajnim ne bashkëpunim me OSCE per antaret e mekanizmit komunal kunder dhunes ne familje ,me temen Kuptimi I Femicitetit ne Kosovë.Ne kete trajnim moren pjesë 16 gra ,shpenzimet e aktivitetit i ka kryer OSBE.

27.Ne dhjetor per ditën nderkombetare të të drejtave te njeriut janë shperndarë posterë ne institucione publike dhe broshura vetdijesuese per te drejtat e njeriut.

28.Ne dhjetor te vitit 2024 është mbajtur takim me grate e institucionit komunal .tema e diskutimit ishte arritja e objektivave gjate vitit 2024 te cilat I prezantoj zyrtarja per barazi gjinore dhe shefja e sektorit per te drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore si dhe u diskutua roli dhe pozita e gruas ne vendimarrje.të pranishme ishin 50 gra dhe bugjeti I shpenzuar per kete aktivitet ishte 50€.

29.Sektori për të drejtat e njeriut dhe zyra për barazi gjinore kanë derguar rekomandime drejtorive perkatese te cilat ndajn grantet dhe subvencione qe te respektohet barazia gjinore si dhe të perkrahen gartë dhe vajzat ne fuqizmin ekonomik.

30. Me datën 12.09.2024 eshte mbajtur aktivitet promovues për të drejtat në punë dhe pushimin e lehonisë.

31.Me datën 03.10.2024 eshte mbajtur aktivitet promovuese për të drejtat në punë dhe pushimin e lehonisë

32.Janë organizuar trajnime per 64 gra të interesuara për ndërmarrësi dhe lidership.

33.Eshtë kryer aktivitet me ish të burgosurit politik të Komunës se Skenderajt ku 8 prej tyre kanë marrë pjesë ne rehabilitim fizikal në banjën në Elbasan nga data 20- 27 Shtator te vitit 2024.

33.Trajnim me gratë mbi shendetin mendor.

34.Per nderë te dites nderkombetare te personave me aftesi te kufizuara eshte mbajtur tryezë diskutimi me perfaqësues komunal .

35.Eshtë mbajtur aktivitet me te rinjët dhe te rejtat me temen Arti kunder dhunes,dhe jane shpernda postera vetdijesues kunder dhunes.

36.Janë mbajtur ligjerata ne shkollat e mesme te Skenderajt per rendësinë e edukimit ne frymen e barazisë gjinore.

37.Eshte mbajtur tryez diskutimi me grate ,te rinjet kunder diskriminimit.

Duke u bazuar ne te dhenat nga Njësia e menagjimit te burimeve njerëzore numri i te punsuarve ne administraten komunale eshte gjithsej 238 prej te cileve 164 janë burra dhe 74 gra.Ne pozitat menaxheriale per vitin 2024 janë 6 gra dhe 8 burra .

Duke u bazuar nga të dhenat e drejtorisë së shëndetësisë numri i te punsuarve gjithsej është 184, ku prej tyre 113 janë gra dhe 71 burra.Ne pozitat menaxheriale janë 24,ku prej tyre janë 14 gra dhe 10 burra.

Duke u bazuar ne te dhenat e ndermarrjes publike Eko natyra numri i te punsuarve te ekonatyres eshte gjithsej 52 puntor ku prej tyre 23 jane gra.

Duke u bazuar ne të dhenat e drejtorisë se Arsimit numri i personelit arsimore eshte gjithsej 865,prej te cileve 384 janë grad he 481 janë burra.

Duke u bazuar ne të dhenat nga Drejtoria per Bujqesi per vitin 2024,perfitues te granteve dhe subvencioneve kane qene 301 ku prej tyre 231 kane qene burra dhe 70 gra.

Duke u bazuar ne te dhenat e drejtorise se urbanizmit numri I emertimeve te rrugeve sipas personave ka qene 558 ndersa ne emer te gjinisë femrore 18.

Duke u bazuar ne te dhenat e drejtorisë se Gjeodezisë dhe kadastër numri i pronave te regjistruara eshte 3310 ,ne emer te gjinisë femrore jane 292 ndersa ne emer te dy bashkshorteve jane 433.

Duke u bazuar ne te dhenat e drejtorisë se zhvillimit ekonomik ndërmarrësi inovacion dhe turizem numri i perfituesve per vitin 2024 jane 74 ku 45 janë gra dhe 31 burra.

Nga te dhenat e marrura nga drejtoria e Kultures dhe sportit perfitues te subvencioneve per vitin 2024 kanë qenë 23 nga te cilet 6 perfitues janë gra.

Sektori per te drejtat e njeriut dhe barazisë gjinore ka bashkëpunuar me Institucionet komunale ,me organizatata jo qeveritare, me shoqerinë civile për realizimin e objektivave sa i perket te drejtave te njeriut dhe barazisë gjinore.

Zyrtare për Barazi Gjinore

Qefserë Dautaj Uka



